

AKT NORMATIV Nr. 1, datë 25.1.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9136, DATË 11.9.2003,
“PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME
TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, duke marrë në konsideratë boshllëkun ligjor të krijuar nga vendimi nr.60/2016, i Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të nenit 4, të ligjit nr.143/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9136, datë 11.9.2013, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe efektet e ndërsjella për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si për të vetëpunësuarit edhe për buxhetin e shtetit, duke marrë në konsideratë kohën e pamjaftueshme për të bërë rregullimet ligjore, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9136, date 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 3, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes.”.

Neni 2

Neni 7, “Regjistrimi në organet tatimore”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Regjistrimi i të punësuarëve në organin tatimor

Personat juridikë ose fizikë, brenda dy ditëve pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, deklarojnë në organin tatimor listën e të punësuarve, pagën përkatëse, përfshirë për personin fizik edhe punonjësit e papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht.

Për personat fizikë të vetëpunësuar pa punëmarrës dhe pa punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon dhe bashkëjeton ligjërisht, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, ky deklaram në organin tatimor bëhet të paktën 3 ditë përpara afatit

të paraqitjes së deklaratës, siç përcaktohet në nenin 11, të këtij ligji, por llogaritja e detyrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet me efekte nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore.”.

Neni 3

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Llogaritja e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe Punonjësën e papaguar të familjes

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar, llogariten si përqindje mbi një pagë bruto, jo më të ulët se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për punonjësën e papaguar të familjes llogariten mbi pagën minimale në shkallë vendi, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësën e papaguar të familjes, llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kur veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit fillon, ndërpritet, përfundon apo kalon në regjistrin pasiv gjatë një muaji, llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore bëhet në bazë të pagës për ditët e punuara për muajin.”.

Neni 4

Dispozita të fundit

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ shfuqizohen:

a) nenet 1 dhe 2, të ligjit nr.144/2015, “Për disa shtesa në ligjin nr.7703, date 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, që ka shtuar shkronjën “d”, të nenit 6, dhe paragrafin e shtuar, pas paragrafit të katërt, të nenit 9, të ligjit;

b) nenet 1, 2 dhe 3, të ligjit nr.145/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10383, date 24.2.2011, “Për sigurimet e detyrueshme të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, që ka ndryshuar përkatësisht nenin 5, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”; nenin 6, pikën 1 dhe paragrafin e dytë, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Botuar ne F.Zyrtare 11 / 2017

Dale nga shtypi me 27.01.2017